

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN BUSHAT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën e Bushat, njësi administrative e Bashkisë Vau i Dejës, Shkodër**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2013 deri më 30.06.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 151, datë 19.11.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 642/7, datë 19.11.2015, i ka rekomanduar z. Zef Hila, Kryetar i Bashkisë Vau i Dejës e cila përfshin ish komunën Bushat si njësi administrative, zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: Raportet vjetore “Mbi cilësinë dhe gjendjen e kontrollit të brendshëm” për vitin 2013 dhe 2014, janë plotësuar me mangësi, nuk ka identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të sistemit të kontrollit të brendshëm, nuk ka patur plan veprimi për trajtimin e mangësive të konstatuara në sistem, për të garantuar përmirësimin e tij në vazhdimësi, gjë e cila është dhe qëllimi kryesor i hartimit të tij. Nuk janë trajtuar të gjithë elementët e kontrollit të brendshëm, veprime këto në kundërshtim me shtojcën nr.7 të “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe me shtojcën nr.2 të udhëzimit nr.28, datë 15.12.2011 të Ministrit të Financave “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

1.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, që raporti vjetor “Mbi cilësinë dhe gjendjen e kontrollit të brendshëm” të përfshijë analizën e funksionimit të këtij sistemi në vitin aktual, duke përcaktuar pikat që kanë nevojë për përmirësim, plan veprimin për trajtimin e mangësive, etj. Në raport të trajtohen elementët e kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi dhe monitorimi.

Brenda muajit Dhjetor 2015

2. Gjetje: Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe për rrjedhojë nuk ka përcaktim të nivelit të pranueshëm të riskut. Nuk është miratuar strategjia e risqeve, sipas nenit nr. 21 të ligjit nr. 10296 të MFK, ku të bëhet identifikimi paraprak, raportimi, analiza, impakti që risqet mund të kenë në arritjen e objektivave. Nuk është hartuar regjistri i riskut për asnjë njësi menaxheriale, në kundërshtim me kërkesat e manualit për zbatimin e ligjit të MFK Kap.III.

2.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të hartojë strategjinë e risqeve, si dhe të hartohet regjistri i riskut të institucionit me persona përgjegjes për çdo njësi menaxheriale me qëllim identifikimin, raportimin dhe trajtimin e risqeve që rrëzikojnë realizimin e objektivave.

Brenda muajit Dhjetor 2015

2. Gjetje: Janë kryer pagesa për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për 6-mujorin e dytë të vitit 2013 për 2 procedura në shumën 6,990,440 lekë, për vitin 2014 për 23 procedura në shumën 4,322,564 lekë dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2015 për 38 procedura në shumën 9,936,805 lekë. Këto procedura prokurimi të kryera u paraqitën mangësi dhe parregullsi në plotësimin e dokumenteve pjesë të dosjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla si: kërkesat për blerje nuk janë të argumentuara, nuk ka argumentim të fondit limit, akti i marrjes në dorëzim i shërbimeve dhe i mallrave është bërë formal nga KPVV dhe jo nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

2.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet dokumentohet i gjithë procesi i punës, që nga hartimi i kërkesave deri në përfundimin e procedurës së prokurimit, mbi bazën e dokumenteve financiare justifikues, autorizues dhe vërtetues, duke vendosur strukturat zbatuese dhe të miratohet nga Titullari.

4. Gjetje: Janë kryer pagesa për shpenzime në zbatim të kontratës të lidhur me Shoqërinë “Ndërkomunale Bushat” sh.a, me objekt “Depozitimi i mbeturinave urbane në vend-depozitim e përpunimit të mbetjeve të ngurta në Bushat”(Landfill), për vitin 2014 në **3 raste** në vlerën **3,498,660 lekë** dhe për vitin 2015 në **2 raste** në vlerën **51,609 lekë**. Marrja në dorëzim e shërbimit nga komisioni i ngritur për këtë qëllim është bërë me procesverbal formal dhe nuk shoqërohej me grafik ditor të tonazhit të transportuar dhe të depozituar në Landfill, veprime këto në kundërshtim me kushtet e kontratës pikën 4.3 “Grafiku i lëvrimet” dhe pikën 4.4 “*Pranimi i mbeturinave urbane dhe peshimi*”, si dhe me VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Kreu VIII , pika 1/(d), Pika 2, “Mbikëqyrja e kontratës” nënpika a dhe b .

4.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, për shërbimin e depozitimit në Landfill të mbeturinave urbane, nga komisioni i marrjes në dorëzim në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve të Bashkisë, të bëhet ndjekja dhe evidentimi ditor sipas një grafiku të përcaktuar në zbatim të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje: Nuk është mbajtur libri inventar me të dhënat e aktiveve të trupëzuara me azhurnimet e përditësuara deri në momentin aktual, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit, në kundërshtim me Kap III, pika 30 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

5.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, Drejtorisë së Financës të krijojë regjistrin e aktiveve, i cili të hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, si dhe grupit përkatës brenda llojit, ku të përfshijnë këto të dhëna: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëvonshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, deri në daljen e tij jashtë përdorimi, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit.

Brenda muajit Shkurt 2016

6. Gjetje: Nuk është hartuar rregullore e veçantë dhe nuk janë pajisur me autorizim nëpunësit që e përdorin programin Financiar “Alfa” dhe regjistrimet e kontabilitetit. Gjithashtu nuk janë përcaktuar personat që kanë të drejtën e kontrollit mbi veprimet e hedhura në sistem (*Trajtuar më hollësisht në faqet 31-36 Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, për të hartuar rregulloren e veçantë për përdorimin e programit Financiar “Alfa”, duke përcaktuar oraret e përdorimit dhe personat e autorizuar për përdorimin dhe kontrollin e këtij programi kontabiliteti, duke patur në objektiv kryesor sigurinë e tij për të mos u përdorur nga persona të pa autorizuar.

Menjëherë e në vijimësi

7. Gjetje: Regjistrimet në kontabilitet në shumë raste janë kryer me 3-4 muaj vonësë, gjatë viteve 2014 e 2015, veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore për mbajtjen e kontabilitetit (*trajtuar më hollësisht në fq31-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, nëpërmjet Sektorit të Kontabilitetit regjistrimet në kontabilitet të dokumenteve kontabël të veprimeve ekonomike të bëhen për çdo muaj, duke eliminuar regjistrimet me vonësë.

Në vijimësi

8. Gjetje: Në bilancin e vitit 2014, llogaria nr. 2315 “Shpenzime në proces për mjete transporti” rezulton me pozicion financiarë në vlerën 15,000,000 lekë, shpenzime të pa mbyllura .

8.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, Sektori i Kontabilitetit të sistemojë vlerën 15,000,000 lekë në llogarinë nr. 215 “Mjete Transporti”, duke mbyllur llogarinë nr. 231 “Shpenzime për mjete transporti”.

9. Gjetje: Në tenderin me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës se varrezave në fshatin Stajkë-Kosmaç” me procedurë, “Kërkesë për propozim” me fond limit 7,283,180 lekë dhe me vlerë të kontratës së lidhur 7,278,180 lekë, ka marrë pjesë në tender vetëm një operator ekonomik “A.....E... shpk”. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), e ka shpallur fitues edhe pse ky operator ekonomik, në të njëjtën kohë kishte kontratën e papërfunduar me këtë Autoritet Kontraktor për ndërtimin e objektit “Rikonstruksion i Ujësjetllësit të Fshatit Melgushë, faza e II-të”. Në këto kushte KVO, duhet të kishte anuluar tenderin dhe Autoriteti Kontraktor nuk duhet të lidhte dy kontrata njëkohësisht, si dhe nuk ka përmbushur detyrën ligjore për verifikimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore, sipas grafikut të punimeve për të dy objektet .

9.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, për të gjitha prokurimet që do të kryej, KVO duhet të marrë masa dhe të analizojë kapacitetet e operatorëve ekonomik, veçanërisht kur ato konkurojnë në të njëjtin AK ose dhe kur ka informacion për objekt tjetër për kontrata të tjera të pa përfunduar. Kjo duhet të reflektohet nga NJP në kushtet e vendosura.

Në vijimësi

10. Gjetje: Në tenderin me objekt “Restaurim i Qendrës Muzeore “Ndre Mjeda”, me vlerë limit të kontratës 7,600,067 lekë dhe vlerë e kontratës 6,823,140 lekë pa tvsh, përllogaritja e fondit limit dhe projekti teknik, është bërë nga Ministria e Kulturës. Preventivi i hartuar nga përfaqësues i Ministrisë së Kulturës, nuk është i shoqëruar me analizën e kostos për çdo zë pune. Zhvillimi i procedurës së prokurimit, nuk duhet të zhvillohej nga Komuna Bushat, pasi është në kundërshtim me VKM nr.216, datë 18.4.2007 “Për procedurat e konkurrimit publik për zgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës”, pasi në komisionin e konkurrimit mungojnë inxhinierë dhe specialistë restaurimi të licencuar nga Ministria e Kulturës dhe Rinisë, kërkesë kjo e pikës II-1c. .

10.1. Rekomandim : Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, që të mos zhvillojë procedura prokurimi për restaurime të monumenteve të kulturës, pa specialistë të fushave përkatëse dhe pa u plotësuar Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me specialistë të fushës së restaurimeve të monumenteve të kulturës deh trashëgimisë kulturore.

Vazhdimisht

11. Gjetje: Komuna Bushat si Autoritet Kontraktor ka caktuar Shoqërinë “Z.....” shpk, për të hartuar Projektin e zbatimit për ndërtimin e objektit “Rikonstruksion i Ujësjetllësit të Fshatit Melgushë, faza e dytë ”, i cili rezulton me të meta e mangësi të theksuara, duke mos argumentuar përcaktimin e sasisë së volumeve për zërat e preventivit të tenderuar, veçanërisht për zërin “Shtresë çaklli mbeturinë gur kave t =20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri” (sistemim rrugicash), në kundërshtim me kushtet e kontratës së shërbimit nr. 821, datë 13.10.2014, me nenin 5 , të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” .

11.1 Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa dhe të kërkojë nga subjektet e kontraktuara, që realizimi i projekteve të jetë në përputhje me kërkesat ligjore e teknike të projektimit, kushtet e kontratës të lidhur ndërmjet palëve, në të kundërt këto projekte të mos merren në konsideratë për tu zbatuar, por të kërkohet plotësimi i tyre.

Vazhdimisht

12. Gjetje: Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, është i pa studiuar dhe i pa mbështetur në analiza dhe të dhëna reale. Kështu planifikimi i të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore është i pa mbështetur në sipërfaqen reale dhe kategorinë e tokës që disponohet nga të dhënat e ZAMT të ish Komunës Bushat. Për vitin 2013 është lënë pa llogaritur e planifikuar një sipërfaqe prej 512 ha, ose 1,003 mijë lekë, për vitin 2014 pa planifikuar 3015 ha, ose 5,437 mijë lekë, për vitin 2015 pa planifikuar 2163 ha, ose 3,920 mijë lekë. Sipërfaqja e tokës që duhet të taksohej për vitin 2013 dhe 2014, është 5736 ha, ndërsa për vitin 2015 kjo sipërfaqe është 5783 ha. Gjithashtu taksa e gjelbërimit për vitin 2013, është planifikuar për 5 mijë familje, ndërkohë që nga të dhënat e gjendjes civile janë 6155 familje, duke lënë jashtë planifikimit 1155 familje, me një vlerë totale të pa planifikuar prej 231 mijë lekë .

12.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, nëpërmjet Sektorit të Ardhurave në bashkëpunim me ZAMT, Zyrën e Gjendjes Civile, të bëjnë një planifikim të saktë të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore për Njësinë

Administrative Bushat, ku të përfshihet e gjithë sipërfaqja e tokës së ndarë. Gjithashtu plani i të ardhurave që do të paraqitet në Këshillin e Bashkisë Vau Dejës për vitin 2016, duhet të shoqërohet me relacion dhe analizë të hollësishme, me argumentim të vlerës së planifikimit për çdo të ardhur nga taksat dhe tarifave vendore.

Brenda muajit Dhjetor 2015

13. Gjetje: Për 6-mujorin e dytë të vitit 2013-2014, janë kryer kontrole 128 subjekte, me proces verbale jo të plota, deri në formale dhe në kundërshtim me pikën nr. 10 “Kontrolli tatimor”, të udhëzimit të MF dhe MB nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”. Gjithashtu për vitin 2014 në **7 raste** është konstatuar se subjektet ushtrojnë aktivitetet pa u regjistruar (pa NIPT) dhe nga ana e zyrës së të ardhurave të ish komunës Bushat, nuk është marrë asnjë masë për mbyllje veprimtarie dhe konfiskim të mallit pa faturë tatimore, në kundërshtim me kërkesat e nenit nr. 41 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar .

13.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, që nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tarifave Vendore, në kryerjen e kontroleve në terren të subjekte private, të jenë objekt kontrolli të gjitha elementët e biznesit, si: përdorimi i kasës fiskale në lëshimin e faturës tatimore, regjistrimi i të dhënave në librin e xhiros, regjistrimi i blerjeve të realizuara për qëllime biznesi (rishitje, përpunim, etj.), matja e xhiros me qëllim vlerësimin e qarkullimit të deklaruar nga tatimpaguesi, etj. Në rastet e konstatimeve të subjekteve pa NIPT të bëhet mbyllja e aktivitetit dhe konfiskimi i mallit sipas procedurave tatimore në fuqi.

Në vijimësi

14. Gjetje: Për planifikimin dhe arkëtimin e taksave “Mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme” dhe “Rregjistrimin e përvitshëm të automjeteve”, Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të ish komunës, nuk ka bashkëpunuar me agjentët tatimor të ZVRPP Shkodër, Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe DRSH të Transportit Rrugor Shkodër, në kundërshtim me nenin nr. 7, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, dhe të UMF nr. 24, datë 02/9/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar .

14.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa, nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tarifave Vendore, që të sigurohet bashkëpunim i vazhdueshëm me ZVRPP Shkodër, Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe DRSH të Transportit Rrugor Shkodër, në lidhje me marrjen e informacionit të nevojshëm, duke bërë akordime periodike në interes të planifikimit dhe të arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore.

Në vijimësi

15. Gjetje: Janë krijuar debitorë në vlerë totale prej **36,554 mijë lekë**, nga mosarkëtimi i të ardhurave të trashëguara para vitit 2013 dhe për periudhën e audituar (2013,- 30.06.2015), nga e cila: Vlera 1,866 mijë lekë për taksën e biznesit të vogël ,vlera 1,737 mijë lekë nga biznesi i madh e i vogël ,për taksën e ndërtesës ,pastrimit , tabelës e reklamës , vlera prej 6824 mijë lekë për tarifën e ujët të pijshëm nga abonentët private e familjarë , vlera prej 26,127 mijë lekë për taksën e tokës bujqësore të ndërtesës, pastrimit dhe parkimit nga abonentët familjarë. Konstatohet se nga ana e Zyrës së Financës në kundërshtim me ligjin nr. 9228 , datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, nga e gjithë vlera e pa arkëtuar 36,554 mijë lekë është kontabilizuar vetëm vlera 2,835 mijë lekë, që i përket vitit 2014 dhe nuk është kontabilizuar vlera prej -33,719 mijë lekë .

15.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa nëpërmjet Drejtorisë të Ardhurave dhe Tarifave Vendore, që të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pashlyera në shumën **36,554 mijë lekë**, vlerë e cila është e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës dhe të përgatiten listat për detyrimet e pashlyera për familjarë dhe subjektet private dhe të dorëzohen në Sektorin e Financës, e cila të kryej veprimet për kontabilizimin e vlerës prej 33,719 mijë lekë.

Brenda muajit Mars 2016

16. Gjetje: Nuk ka një program të miratuar nga Titullari për ngritjen e grupeve të punës për kryerjen e inventarizimeve fizike te pronave në pronësi të ish-Komunës Bushat, sipas përcaktimeve të listës të miratuar me VKM, verifikimin në terren dhe marrjen e informacionit zyrtar pranë organeve përkatëse të ndryshimeve të statusit të tyre, që në momentin e transferimit

e në vazhdim dhe në rast të mospërputhjeve nuk janë bërë azhurnimet përkatëse në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 11/4 dhe nenin 12/f dhe me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” kap. IV “Sistemi periodik i aktiveve” .

16.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa, për kryerjen e procedurës së inventarizimit dhe të saktësojë të dhënat për çdo pronë, ndryshimet e ndodhura deri në momentin aktual, për të gjitha pronat e listës përfundimtare të miratuar nga VKM përfundimtare.

Brenda muajit Mars 2016

17. Gjetje: Në auditimin e administrimit dhe rregjistrimit të pronave kaluara në pronësi të ish komunës Bushat në ZVRPP Shkodër, rezultoi se një pjesë të vogël e pronave, veçanërisht për pronat e dhëna me qira janë kryer procedurat ligjore për regjistrimin në ZVRPP, Shkodër. Ndërsa, për pjesën më të madhe të pronave nuk kanë përfunduar procedurat për regjistrimin në ZVRPP, në kundërshtim me kërkesat e neni 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme” dhe neni 30 dhe 35/a të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

17.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa, që të vazhdohen procedurat e regjistrimit në ZVRPP për të gjitha pronat e kaluara në pronësi të ish-komunës Bushat, duke mbajtur korrespondencë të vazhdueshme në lidhje dhe me plotësimin e dokumentacionit tekniko –ligjor, ndërsa për pengesat të kërkohet zyrtarisht ndihmë nga organet eprore ZQRPP dhe Ministria e Drejtësisë, nga të cilat varen ZVRPP Shkodër.

Brenda 6 muajit I të vitit 2016

18. Gjetje: Në vitin 2013, ish komuna Bushat ka lidhur **31 kontrata** për dhënien me qira të **81.79 ha** të fondit pyjor në përdorim të tokave pyjore për agropylltari (mbjellje ullishte) me afat 6-10 vjet. Dhënia me qira, nuk është bërë me procedurë konkurrimi. Në praktikat e dhënies me qira mungojnë kërkesat e aplikuesve me të gjithë elementet përbërës, procesverbalet e dorëzimit të parcelës. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UKM. nr. 4, datë 22.4.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 1,11,19 dhe 24/d. Nga ish komuna Bushat nuk është marrë miratimi paraprak i DRSH Pyjor Shkodër, për përdorim të ngastrave të tokës nga fondi pyjor në kundërshtim me VKM nr. 22, datë 9.1.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pika 6 .

18.1. Rekomandim:

a. Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës dhe të rivlerësojë të gjitha kontratat e nënshkruara dhe për mos plotësimin e kushteve apo ndryshim destinacioni të përdorimit të fondit të tokës, të marrë masa deri në prishjen e kontratave.

Brenda muajit Janar 2016

b. Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa, për të gjitha rastet e dhënies me qira të ngastrave nga fondi pyjor e kullor, që ka në administrim, të sigurojë që të zbatohen në të gjitha fazat, kushtet e procedurës së dhënies me qira sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në vijimësi

19. Gjetje: Ish komuna Bushat ka lidhur kontratë qiraje me nr. 1434/532 datë 6.9.2011 me firmën “Alb Tiefbau” sh.p.k., për dhënie me qira të pronës (me çertifikatë pronësie qiraje nga ZVRPP), llojit “kullotë (zallishte)”, me nr. pasurie 685/19 në ZK nr. 3506 fshati Stajkë me sipërfaqe **159,000 m²**, për nxjerrje-prodhim-depozitim inertesh me afat 30 vjet. Dhënia me qira e enfiteozë e pasurisë **të llojit kullotë**, është në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011, pika 2. Nuk është përlllogaritur dhe nuk është sanksionuar në kontratë **tarifë qiraje për 100.000 m² nga 159.000 m² të marrë me qira nga subjekti privat**. Vendosija e afatit prej 30 vjet, kur afati i dhënies me qira është deri në 20 vjet, pra kemi 10 vjet qira më shumë, është në kundërshtim me pikën 6/a, b dhe pika 7, të dispozitës së sipërcituar.

19.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa:

- Për të revokuar menjëherë kontratën e qirasë me firmën “A.....” sh.p.k, duke ngritur grup pune me njohuri të mjaftueshme juridike dhe ekonomike, për rishikimin e statusit juridik të saj sipas

kërkesave ligjore në fuqi, duke hequr afatin e paligjshëm prej **30 vjet** dhe kthyer atë në **20 vjet** dhe llogaritjen dhe arkëtimin e tarifës shtetërore për sipërfaqen e pa llogaritur padrejtësisht në dëm të pasurisë publike për sipërfaqe prej **-59000m²** (159000m²- 100000m²).

- Të përcaktojë saktë formën e dhënies me qira të pronës kullotë, me afatin e saj sipas kopetencave ligjore që ka Bashkia Vau i Dejës dhe përcaktimit të masës së tarifës së qirasë, për të gjithë sipërfaqen e dhënë me qira pra 159000m², sipas VKM përkatëse.

Menjëherë

20. Gjetje: Me datë 20.07.2009 dhe nr. noterial 2968/1900 nga ish Kryetari i Komunës Bushat është lidhur kontratë me shoqërinë “VMK”sh.p.k. për dhënie me qira të pronës të llojit tokë arë, me sipërfaqe 20.080 m² e ndodhur në fshatin Plezhë, **afat 99 vjet**, me qëllim neni 2 i cili përcakton: *“Dhënia me qira për aktivitet privat të qiramarrësit (ndërtimin e një objekti-thertore dhe në perspektive ndërtimi një fabrikë përpunimi mishi)”. Kjo kontratë është në kundërshtim me ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, neni 14 “Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet” pika 1, me UKM nr. 3, datë 16.5.2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” Kreu II pika 4 dhe pika 1, e cila përcakton “Deri në 30 vjet, për kontratat afatmesme, për ndërtimin e fidanishteve, serrave, të prodhimeve blegtorale etj;”.*

Më datë 27.08.2009, është kryer lidhja e një marrëveshje për krijim Uzufuktin ndërmjet ish Komunës dhe firmës “VMK”shpk. Në nenin 232 të Kodit Civil përcaktohet se: *“Uzufukti është e drejta e një personi (uzufuktari) për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë e ta mirëmbajë atë”*. Kjo Marrëveshje është krijuar për të drejtën e uzufuktit mbi pasuritë e llojit pemëtore (sipërfaqe 20.080m²) me qëllim: zhvillimin ekonomik të zonës nxitjen e punësimit, rritjen e kapaciteteve prodhuese të prodhimeve blegtorale në zonën e Bushatit, me afat **prej 30 vitesh dhe pagesë në shumën 100,000 lekë në vit**. Kjo marrëveshje është krijuar pa kryer veprim juridik apo ligjor për anulimin e kontratës së parë, e cila nuk ka pushuar së vepruari, pasi ka një afat prej 99 vjet, në kundërshtim me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me UKM nr. 3, datë 16. 5. 2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”, **pika 11**, në të cilën nuk është e parashikuar dhënia me qira e tokës bujqësore me marrëveshje uzufukti, por sipas kontratës tip të miratuar me UMB nr. 234, datë 09.07.2007 "Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së "Kontratës tip për dhënie me qira të tokave bujqësore, të pandara, pasuri shtetërore" dhe të "Formularit Tip të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore". Kjo marrëveshje nuk është krijuar me akt noterial, por vetëm është noterizuar **9 muaj pas krijimit**, në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Titulli IV “Uzufukti”, Kreu I, neni 235. Përcaktimi i masës së shpërblimit prej 100,000 lekë në vit për uzufuktin e krijuar, nuk është bazuar në asnjë dispozitë ligjore. Nisur nga qëllimi i krijimit të uzufuktit që është nxitja e biznesit, përcaktimi i shpërblimit duhej bërë në bazë të VKM nr. 529 datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Marrëveshja për krijimin e uzufuktit është një veprim juridik i pavlefshëm, pasi nuk është krijuar sipas ligj dhe është në kundërshtim me ligjet për tokat bujqësore dhe mbrojtjen e tyre, si dhe me aktet nën ligjore në zbatim të tyre. Sipas ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kreu IV “Mbarimi i uzufuktit”, në **nenin 256** “Pushimi i uzufuktit”, **përcaktohet se:** *“Uzufukti mund të pushojë, kur uzufuktari shpërdoron të drejtat ose nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga uzufukti”*

Si rezultat i mos përmbushjes së detyrimeve dhe qëllimit të lidhjes së marrëveshjes nga Uzufuktari, nga ish Komuna Bushat, nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për pushimin e Uzufuktit .

20.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa për revokimin e menjëhershëm të kontratës me subjektin “V....sh.p.k. duke anuluar e bërë të pavlefshëm kontratën datë 20.07.2009 dhe marrëveshjes së Uzufuktit të datës 27.08.2009, pasi janë të pavlefshme ligjërisht si rezultat i shkeljeve ligjore të konstatuar në lidhjen e tyre.dhe pa ndjekur procedurat administrative e ligjore.

Menjehere

21. Gjetje: Komuna Bushat në vitin 2008, ka proceduar për dhënie me qira të **15.662 ha** nga fondi i tokave të pandara, duke lidhur 25 kontrata për përdorim për ullishte, nga të cilat 19 kontrata janë me afat kohor 99 vjet dhe 6 kontrata me afat 30-vjet. Dhënia me qera e tokave

bujqësore të pandara prej **15.662 ha**, është bërë vetëm me vendim Bordi (BQTBP), pa u miratuar me Vendim të Këshillit të Komunës, në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004, neni 32, shkronja (ë) "Detyrat e këshillit bashkiak ose komunal", Nuk kishte gjurmë për zhvillimin e procedurës së konkurrimit, pasi mungon procesverbali i hartuar nga Bordi për përshkrimin e procedurës dhe vlerësimin me pikë të ofertave të paraqitura në ankand; Plan-bizneset e paraqitura nga personat e interesuar për marrjen me qira të tokave të lira nuk përmbajnë garancinë bankare (dokument bankar); kontratat nuk janë lidhur nga Kryetari i Komunës, por nga person i autorizuar prej tij; Kontratat nuk janë lidhur me akt noterial dhe nuk janë regjistruar në ZVRPP Shkodër, si dhe dorëzimi i parcelave të tokës qiramarrësit, nuk është bërë me procesverbal në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", neni 826, pika 4. Në këto parcela toke nuk ka raste të kontrollit të dokumentuar me procesverbal në kundërshtim me kontratat e lidhura, Kreu "Dispozita të veçanta", pika nr. 4.

21.1. Rekomandim : Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa:

a. Për të revokuar dhe bërë të pavlefshme në mënyrë administrative dhe nëse është nevoja në rrugë ligjore 25 kontratat për dhënie me qira për përdorim për ullishte, nga të cilat: 19 kontrata janë me afat kohor 99 vjet dhe 6 kontrata me afat kohor 30-vjet për sipërfaqen e tokave bujqësore të pandara prej 15.662 ha, pasi janë lidhur në kundërshtim me ligjin dhe jashtë kopetencave ligjore që ka patur kryetari i komunës Bushat.

Menjëherë

22. Gjetje: Në tenderin me objekt: "Ndërtim trotuari fshati Rranxa" me fond limit 1,833.333 lekë, me procedurë "Kërkesë për propozim". Në tender kanë marrë pjesë 2 (dy) operatorë ekonomik "K....." shpk dhe "J....." shpk, ku "K....." shpk me vlerë oferte 1,167,994 lekë është tërhequr, duke argumentuar se është i angazhuar në kontrata të tjera.

. Kontrata nuk është lidhur, diferenca midis dy preventivave në shumën 197,407 lekë, nuk ka sjellë efekt financiar.

22.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa për të njoftuar zyrtarisht dhe kërkuar APP për përjashtimin nga pjesëmarrja në tendera për një afat të caktuar të subjektit privat "J....." sh.p.k., konform kërkesave ligjore, për shkak se ka marrë pjesë në tenderin "Ndërtim trotuari fshati Rranxa" më datë 24.06.2015 me dy preventiva me vlera të ndryshme, *duke u shpalluar fitues me vlerën më të lartë*, sipas formularit të njoftimit të fituesit nr. 881, datë 03.07.2015.

Menjëherë

23. Gjetje : Në tenderat me objekt: "Furnizim me ushqim për nxënësit e konviktit të shkollës së mesme profesionale "Ndre Mjeda, Bushat" të zhvilluara për vitet 2013-2015, nuk është bërë e saktë llogaritja e nevojave për ushqime, të cilat sipas rregullit, planifikimi për furnizim me ushqime duhej bërë 275 ditë shkollore për periudhën Janar-15 Qershor dhe 15 Shtator-Dhjetor të vitit buxhetor.

Për vitin 2015 janë zhvilluar dy tenderë për blerje ushqime me vlerë totale limit të kontratës 5 868 076 lekë pa tvsh dhe 6 624 834 lekë me tvsh, në të cilat janë llogaritur 200 ditë më tepër për furnizim me ushqim, (475 ditë të planifikuara nga AK- 275 ditë viti shkollor) që i përket vlerës prej **1 619 326 lekë dëm ekonomik**, për këtë zbatim të kontratës së vitit 2015 është në proces.

23.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa dhe të ngrëjë grup pune, të cilët të vlerësojnë me përgjegjësi vlerën ushqyese dhe kushtet e ruajtjes brenda afatit të skadencës, të ushqimeve të blera për vitin 2015, duke evidentuar diferencat sipas normativave të ushqimit e kalorive të nevojshme dhe vënë para përgjegjësisë për zhdëmtim personat përgjegjës e shmangur abuzimet.

Brenda muajit Dhjetor 2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa, të kryej kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim *për shpërblimin e dëmit me vlerën 34,779,013 lekë*, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje: Në 4 raste janë kryer pagesa për paga në kundërshtim me dispozitat ligjore **me pasojë dëm ekonomik në shumën prej 121,072 lekë**, ku në 1 rast është paguar në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008. «Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore», i ndryshuar dhe në 3 raste janë paguar në kundërshtim me VKM nr. 194 datë 22.04.99 ”Për miratimin e strukturës së pagës të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” .

1.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **121,072 lekë** përkatësisht: **z. F.Zh** në shumën **27,586 lekë**, **zj. L.M** në shumën **51,990 lekë**, **nga z. K.Sh** në shumën **25,578 lekë** dhe **z. S.L** në shumën **15,918 lekë**.

Brenda muajit Shkurt 2016

2. Gjetje: Me urdhër-shpenzimin nr. 173, datë 08.07.2013 në vlerën 400,000 lekë është paguar personi fizik “P.D” në bazë të faturës nr. 4 datë 22.12.2012(seri 0023542) për shërbimin shpim pusi 50 ml x 8000 lekë/ml. Nuk ka bashkëlidhur situacion për volumet e punimeve të kryera, kërkesën nga Sektori i Shërbimeve, skicë dhe preventiv paraprak, për përcaktimin e volumeve të punës dhe vlerës së këtij punimi, referuar analizave të çmimeve të manualeve të punimeve të ndërtimit mbi bazën e së cilës të përcaktohej fondi limit. Sipas faturës dhe ofertave të paraqitura çmimi, procedura e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu II “Rregulla të përgjithshme të Prokurimit” pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës” nën-pika (c), Kreu i VI, pikës 2/a dhe me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, me pasojë **dëmin ekonomik prej 269,700 lekë** .

2.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **269,700 lekë** nga **personi fizik P.D**, të përfituar padrejtësisht mbi çmimet e miratuara për shërbimin “shpim pusi”.

Brenda muajit Shkurt 2016

3. Gjetje: Janë kryer pagesa më tepër për shpenzime për telefoninë celulare në dispozicion të z. Zef Hila ish Kryetar i Komunës, në kundërshtim me pikën 9 dhe 11 të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për Pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, duke shkaktuar **dëmin ekonomik në vlerën 124,000 lekë** .

3.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **124,000 lekë** nga z. Z.H, të përfituar padrejtësisht për përbalimin e shpenzimeve të shërbimit për telefoninë celulare.

Brenda muajit Shkurt 2016

4. Gjetje: Është bërë pagesë Shoqatës “N....Z....”, për periudhën objekt auditimi në bazë të akt-marrëveshjeve vjetore pa nr. prot., të datës 07.01.2013, të datës 07.01.2014 dhe të datës 01.04.2015, lidhur ndërmjet Njësive Vendore anëtare dhe kontribuuese të shoqatës si Bashkia Vau-Dejës, Komunitat: Dajç, Blinisht, Hajmel, Bushat dhe Shoqatës jo-qeveritare “Ndërkomunalja e Zadrimës” për aktivitete, studime e projekte të ndryshme, fushata publicitare dhe shërbimin e pastrimit. Shoqata “N Z.....”, ka përfituar pagesë me pa të drejtë për shërbimin e transportit dhe depozitim në Landfill të mbeturinave urbane për ish komunën Bushat, kur shërbimi për pastrimin, grumbullimin dhe transportin e mbeturinave mbulohet nga vetë Komuna me mjetet e veta dhe shërbimi i depozitimit në Landfill realizohet nga Shoqëria Ndërkomunale Bushat nëpërmjet kontratës së lidhur, duke shkaktuar **dëmin ekonomik në shumën 1,700,696 lekë** për buxhetin e Komunës .

4.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **1,700,696 lekë** nga Shoqata “N....Z.....”, përfituar padrejtësisht për punë të pakryer për shërbimin e transportit dhe depozitimit të mbeturinave urbane.

Brenda muajit Janar 2016

5. Gjetje: Në tenderin me objekt: “Ndërtim trotuari fshati Rranxa” me fond limit 1,833.333 lekë, me procedurë “Kërkesë për propozim”. Në tender kanë marrë pjesë 2 (dy) Operatorë ekonomik “K....” shpk dhe “J.....” shpk , ku “K....” Shpk me vlerë 1,167,994 lekë është

tërhequr, duke argumentuar se është i angazhuar në kontrata të tjera. Për tërheqjen e OE, nga KVO duhej të ishte kërkuar konfiskimi i sigurimit të ofertës në masën 2% ose me vlerë **23,359 lekë** dhe të njoftonte me shkrim titullarit i autoritetit kontraktor .

5.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa për ndjekjen e procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e sigurimit të ofertës nga subjekti “K.....” Shpk në vlerën **23,359 lekë**, i cili është tërhequr nga zhvillimi i tenderit me objekt “Ndërtim trotuari fshati Rranxa” ditën e zhvillimit të tenderit datë 24.06.2015, ose në të kundërt të zhdëmtohet nga anëtarët e KVO në mënyrë proporcionale.

Menjëherë

6. Gjetje: Për periudhën 2013-2015, AK ka kryer procedurat e prokurimit për shtese kontrate për objektin “Karburant dhe lubrifikant për automjetet”. Në këto procedura prokurimi janë konstatuar këto parregullsi: nuk plotësojnë kushtet e emergjencës, nevojës ekstreme për aplikimin e procedurës; Shtesat e kontratave, nuk janë bërë në fillim të vitit buxhetor pasardhës për plotësimin e nevojave në fillim vitit deri në prokurimin vjetor, por janë shtrirë deri më datë **17.06.2014** mbi kontratën bazë të vitit 2013 dhe shtesa mbi kontratën bazë të vitit 2014, është shtrirë deri në mesin e vitit 2015; Shtesat e kontratave janë kryer brenda periudhave, në të cilat shtriheshin kontratat baze, duke shkaktuar **dëmin ekonomik në vlerën 2,244,100 lekë**.

6.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e dëmit në mënyrë solidare në vlerën **2,244,100 lekë** nga : **Z. Z.H ish kryetari i Komunës**, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe nënshkrues i kontratës, **znj. J.M me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit** dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues, vlerë e cila i përket kontratave shtesë mbi kontratat bazë të viteve 2013 dhe 2014.

Brenda muajit Mars 2016

7. Gjetje: Në tenderin “Blerje dokumentacioni” operatori ekonomik “R.....” sh.p.k është tërhequr 6 ditë pas hapjes së tenderit nga KVO, pavarësisht se oferta e tij ishte me ulet. Nga Autoriteti Kontraktor nuk është konfiskuar oferta në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, **duke shkaktuar dëmin ekonomik në shumën 13,130 lekë**.

7.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga operatori ekonomik ‘R.....’ sh.p.k të shumës prej **13,130 lekë**, vlerë që i përket sigurimit të ofertës.

Menjëherë

8. Gjetje: Ish Komuna Bushat në cilësinë e Autoritetit Kontraktor për zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtim i rrjetit KUZ për fshatrat Bushat 2, Rranxa 2, Fshat i Ri 2 dhe Barbullush 2, faza e dytë” ka kryer **pagesa të tepërta në vlerën 12,256,640 lekë** në favor firmës “S.....” sh.p.k., për punime të pakryera në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 1204, datë 12.09.2012 për **25 zëra punimesh** dhe si diferencë volumesh për **6 zëra punimesh**, të konstatuara nga krahasimi i situacioneve të paraqitura me punimet në terren .

8.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa për përfundimin e punimeve të pa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **12,256,640 lekë** nga firma “S....” sh.p.k., përfituar padrejtësisht në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtim i rrjetit KUZ për fshatrat Bushat 2, Rranxa 2, Fshat i Ri 2 dhe Barbullush 2, faza e dytë ”.

Brenda muajit Mars 2016

9.Gjetje: Komuna Bushat në cilësinë e Autoritetit Kontraktor për zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion i Ujësjetës të Fshatit Melgushë, faza e dytë ” ka kryer **pagesa të tepërta në vlerën 12,330,266 lekë**, për llogari të firmës “A.....u” shpk, për punime të pakryera në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 1709, datë 24.12.2014 si diferencë volumesh për **7 zëra punimesh** dhe ndryshimit gjatë zbatimit për **një zë punimi**, të konstatuara nga krahasimi i situacioneve të paraqitura me punimet në terren .

9.1. Rekomandim : Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **12,330,266 lekë** nga firma “ALB-Tiefbau” shpk, për sa ka përfituar padrejtësisht, për punime të pa kryera në ndërtimin e objektit, “Rikonstruksion i Ujësjetës të Fshatit Melgushë, faza e dytë ”.

Brenda muajit Mars 2016

10. Gjetje: Nga qiramarrësit e ngastrave të fondit pyjor e kullosor, 26 prej tyre nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore në shumën 264,550 lekë, në kundërshtim me ligjin 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë” neni 420 dhe 693, me kontratat e lidhura neni 5 “Pagesa dhe regjimi i saj” dhe me pikën 21 të UKM. nr. 4, datë 22.4.2013. Në asnjë rast të pagesës me vonesë, nuk është aplikuar kamata e vonesës të parashikuar në nenin 5 të kontratës. Ndërsa për rastet e mos pagesës të qirasë për gjithë periudhën që nga lidhja e kontratës nuk janë ndjekur procedurat ligjore për zgjidhjen e kontratës për mos përmbushje të detyrimeve kontraktore të parashikuara në kontratë neni 7 dhe 9 .

10.1. Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të pashlyera në shumën **264,550 lekë** nga **26 përdoruesit** të ngastrave të marra me qira nga fondi i pyjor e kullosor pronë e Komunës .

Brenda muajit Dhjetor 2015

11. Gjetje: Në kontratën e datës 06.05.2008 me Shoqërinë A..... për dhënie më qira parcele pyjore për instalim antene të telefonisë celulare me afat 9 vjeçar, tarifa e qirasë e përcaktuar në këtë kontratë në shumën **315,000 lekë** në vit sipas VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja II (9,000,000lek/ha/vit x 350m²). Kjo Shoqëri për periudhën e kontraktuar nuk ka shlyer detyrimet kontraktore për vitet 2009,2010, 2014,2015 dhe një diferencë viti 2008, në kundërshtim me nenin 6 të kontratës dhe me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë” neni 420 dhe 693, duke shkaktuar **dëmin ekonomik në shumën 1,291,500 lekë**. Nga ish Komuna Bushat, nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtimin e kësaj shume, në kundërshtim me nenin 11.1 të kontratës. Gjithashtu nuk është bërë asnjë rishikim i kontratës në lidhje me ndryshimin e tarifës së çmimit me ndryshimin dhe miratimin e *aktit nënligjor* VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" të parashikuar në pikë 6.3 të nenit 6 të kontratës. Ndryshimi i tarifave sjell ndryshim çmimi nga 315,000 lekë në 350,000 lekë (10,000,000lek/ha/vit x 350m²), e cila nuk është përlllogaritur dhe sanksionuar në kontratë. Diferenca e çmimit prej 35,000 lekë nga viti 2010-2015 e pa arkëtuar për 4 vjet ka shkaktuar **dëmin ekonomik në shumën 140,000 lekë** (35,000 lek/vit qiraja x 4 vjet).

11.1. Rekomandim : Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga **Shoqëria A....** të shumës **1,431,500 lekë**, që përfaqëson detyrimet kontraktore të pashlyera dhe diferencën e tarifës së qirasë si pasojë e ndryshimit të çmimit me ndryshimin dispozitës ligjore të sipërpërmendur për një periudhë 4-vjeçare .

Brenda muajit Shkurt 2015

12.Gjetje: Nga ish Komuna Bushat nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar z.Gjovalin Suka, është lidhur kontratë enfiteoze me nr.1434/532 datë 6.9.2011 me firmën “Alb Tiefbau” shpk për dhënie me qira të pronës (me certifikatë pronësie nga ZVRPP) “kullotë (zallishte)” me nr. pasurie 685/19 në ZK nr. 3506 fshati Stajkë me sipërfaqe 159000 m², për nxjerrje-prodhim-depozitim inertesh me afat **30 vjet**. Në pikën 3 të kësaj kontrate “Afati i enfiteozës dhe pagesa”, është përcaktuar dhe përlllogaritur tarifa e qirasë në vlerën 2,596,000 lekë/vit vetëm për sipërfaqen prej 59000m² të instalimit të linjës së nxjerrjes-prodhim-depozitim në nxjerrje të inerteve dhe jo për sipërfaqen prej 100000 m² të depozitimit të inerteve, që përlllogaritet 1,000,000 lekë në vit sipas lidhjes II, pika 14/2 (100000 m² = 10 ha x 100,000 lekë/ha/vit). Kjo tarifë nuk është përlllogaritur dhe nuk është përfshirë në pikën e pagesës të kontratës, si rrjedhojë nuk është arkëtuar për gjithë periudhën, që nga lidhja e kontratës deri në vitin 2015 në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", duke shkaktuar **dëmin ekonomik në shumën 4,000,000 lekë**.

Rekomandim : Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësia administrative Bushat të marrë masa(përveç masave administrative) dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga **firmën “A.....” shpk** të shumës **4,000,000 lekë**, që përfaqëson vlerën e qirasë për 100,000 m² të marrë për përdorim për depozitim inertesh dhe të pa llogaritur si dhe të pa sanksionuar në kontratë, për gjithë periudhën e kontraktuar deri në vitin 2015.

Brenda muajit Shkurt 2016

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 171, datë 26.3.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, **i kemi rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës :**

Të vlerësojë me përgjegjësi mangësitë dhe shkeljet e trajtuara për secilin punonjës në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të filloj procedurat për dhënien e masave disiplinore “Vërejtje me paarlajmërim”, deri në “Largim nga puna” për:

1. Zj. J.M me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues, në cilësinë e anëtares së komisionit për llogaritjen e vlerës limit të kontratës publike.

- Për kryerje pagesash më tepër për shpenzime për telefoninë celulare në dispozicion të Kryetarit të Komunës në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për Pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, pika 9 dhe 11, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën **124,000 lekë**

- Për pagesat e bëra në lidhje me kontratat shitesë për prokurimin me objekt “blerje karburant dhe lubrifikant”, të cilat janë lidhur pa u mbyllur kontratat bazë në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 dhe nenin 43 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”.

2. Zj.A.N me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kontabilitetit dhe në cilësinë e kryetarit të KPVV :

- Për hartimin e listë pagesave në mënyrë të gabuar për pagat e 4 punonjësve në kundërshtim me VKM nr. 1619 datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM nr. 194, datë 22.04.1999 “Për miratimin e strukturës së pagës të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” me pasojë dëmin ekonomik prej **121 072 lekë**.

- Për parregullsitë e konstatuara në plotësimin e dosjes së procedurave të prokurimit e blerjeve me vlera të vogla, si kërkesat për blerje nuk kanë të argumentuara nevojat, nuk ka argumentim se si është përlogaritur vlera limit e kontratës, (fondit limit), akti i marrjes në dorëzim i shërbimeve dhe i mallrave është bërë nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla dhe jo nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

- Për përcaktimin e vlerës limit të kontratës së blerjes me procedurën e prokurimit me vlera të vogla të shërbimit “shpim pusi”, në vlerë më të lartë se çmimi i manualit të miratuar me VKM nr. 568 datë 26.07.2013 për zërin shpim pusi 20 m komplet + aksesore të analizës (2.an-1) tek tabela “Analiza të reja për punime ujësjellësi në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu II “Rregulla të përgjithshme të Prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës” nën-pika (c), me pasojë dëmin ekonomik 269,700 lekë

3. Z. Zh.S me detyrë specialist IT, inspektor pritje informimi dhe në cilësinë e anëtarit të KPVV (për periudhën 01.07.2013-31.12.2014) dhe me detyrë magazinier për periudhën 01.01.2015 e në vazhdim).

- Për parregullsitë e konstatuara në plotësimin e dosjes së procedurave të prokurimit e blerjeve me vlera të vogla si kërkesat për blerje nuk kanë të argumentuara nevojat, nuk ka argumentim se si është përlogaritur vlera limit e kontratës (fondit limit), akti i marrjes në dorëzim i shërbimeve dhe i mallrave është bërë nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla (KPVV) dhe jo nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

- Për fletë-daljet e magazinës nuk ka bashkëlidhur urdhër dorëzimit apo me preventivin e materialeve për rastet e kryerjes së punimeve për mirëmbajtje në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 38.

4. Z. Nikoll Marku me detyrë, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit të pastrimit, për:

- Mos menaxhimin e nevojave dhe hartimin e kërkesave të argumentuara në të gjitha rastet e blerjeve me vlera të vogla në kundërshtim me me VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu II “Rregulla të përgjithshme të Prokurimit”

- Për procesverbalet e marrjes në dorëzim të shërbimit të kryer për heqje dhe transport të mbeturinave urbane nga Shoqata Ndërkomunale “Z.....” të hartuara në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011”, pika 35/b ,36 si dhe procesverbalet e monitorimit të zbatimit të kontratës për kryerjen nga Shoqëria N.....Z sha të shërbimit të kontraktuar për depozitimin e mbeturinave urbane në Landfill të hartuara në kundërshtim me kontratën pikën 4.3 “Grafiku I lëvrimit” dhe pikën 4.4 “Pranimi i mbeturinave urbane dhe peshimi”si dhe me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar Kreu VIII , pika 1/(d), Pika 2/a,b. “Mbikëqyrja e kontratës”

5. Z. S.G me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit të pastrimit.

- Për procesverbalet e marrjes në dorëzim të shërbimit të kryer për heqje dhe transport të mbeturinave urbane nga Shoqata Ndërkomunale “Z.....” të hartuara në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35/b ,36.

6. Z.Gj.S me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të ZMMT-së, aktualisht ne funksionin e Administratorit të Njësisë Administrative Bushat dhe në cilësinë e nënshkruesit të kontratave të dhënies me qira të parcelave nga fondi pyjor e kullosor pronë e komunës.

- Për parregullsitë e konstatuara në lidhjen e kontratës enfiteoze me nr.1434/532, datë 6.9.2011

- Për mos përcaktim dhe mosllogaritje në pikën 3 të kontratës “Afati i enfiteozës dhe pagesa” të tarifës së qirasë të sipërfaqes prej 100.000 m2 nga sipërfaqja prej 159.000 m2 të dhënë në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ”Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", duke shkaktuar dëmin ekonomik në shumën 4,000,000 lekë.

. - Për parregullsitë e konstatuara në procedurat e 25 rasteve të dhënies me qira të tokave të pandara në kundërshtim me ligjin nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” me UKM nr. 3, datë 16.5.2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”,

- Në lidhje me parregullsitë e konstatuara në procedurat e dhënies me qira të parcelave të tokës prej 81.79 ha nga fondi pyjor dhe kullosor për 31 kontratat e lidhura në kundërshtim me pikën 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9385 datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të nenit 17 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar dhe me UKM nr. 4, datë 22.4.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik”pika 1,11,19 dhe 24/d, si dhënia me qira pa procedurë konkurrimi;

- Nga përdoruesit e këtyre ngastrave 26 prej tyre nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore në shumën 264,550 lekë në kundërshtim me kontratat e lidhura neni 5 “Pagesa dhe regjimi i saj” dhe me pikën 21 të UKM nr. 4, datë 22.4.2013.

7. Z. N.Sh me detyrë inspektor MMT dhe në cilësinë e sekretarit të (BQTBP), ku në bazë të në VKM nr. 532, datë 31.10.2002, “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në Qark dhe zyrat e Menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në Komunë dhe Bashki”. Paragrafi i II-të “Funksionet dhe detyrat e Zyrës së Menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pika 3.

- Në lidhje me parregullsitë e konstatuara në procedurat e dhënies me qira të parcelave të tokës prej 81.79 ha nga fondi pyjor dhe kullosor për 31 kontratat e lidhura në kundërshtim me pikën 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9385 datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të nenit 17 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar dhe UKM. nr. 4, datë 22.4.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik”pika 1,11,19 dhe 24/d, si dhënia me qira pa procedurë konkurrimi. Në praktikat e dhënies më qira, mungojnë kërkesat e aplikuesve me të gjithë elementet përbërës, mungojnë procesverbalet e dorëzimit të parcelës në kundërshtim me UKMnr. 4, datë 22.4.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik”, pika 1,11,19 dhe 24/d. Nuk është marrë miratimi paraprak i DRSHP për përdorim të ngastrave të tokës nga fondi pyjor, në kundërshtim me VKM nr. 22, datë 9.1.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal” pika nr. 6.

- Nga përdoruesit e këtyre ngastrave **26 prej tyre nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore në shumën 264,550 lekë**, në kundërshtim me kontratat e lidhura neni 5 “Pagesa dhe regjimi i saj” dhe me pikën 21 të UKM nr. 4, datë 22.4.2013

8. Z. F. Zh me detyrë Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave Vendore,

9. Z. I.M me detyrë Inspektor në Sektorin e të Ardhurave,

10. Z. Z.L me detyrë Inspektor në Sektorin e të Ardhurave (për periudhën 01.07.2013-31.12.2013):

- Për punë të dobët në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave. Për vitin 2013 nga 70,400 mijë të ardhura të planifikuara janë realizuar 45,672 mijë lekë, ose në masën 65%, për vitin 2014 nga 70,500 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 52,976 mijë lekë ose në masën 75% dhe për 6-mujorin e parë e vitit 2015 nga 42,790 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 37,245 mijë lekë ose në masën 87 %. Në total vlera e akumuluar e taksave dhe tarifave të pa arkëtuara, duke përfshirë edhe periudhën përpara vitit 2013 është 36,554 mijë lekë.

- Për moszbatimin gjatë kryerjes së kontroleve në subjektet private të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pikës nr. 10 “Kontrolli tatimor”, të udhëzimit të MF dhe MB nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”.

- Për mungesë bashkëpunimi me agjentët tatimor ZRPP, Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe DRSH të Automjeteve Shkodër, për “Taksën mbi kalimin e drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme” dhe taksën nga “Regjistrimi i përvitshëm i automjeteve”, në kundërshtim me të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7, dhe të UMF nr. 24, datë 02/9/2008 në zbatim të tij.

11. Z. I.G me detyrë Inspektor i Zhvillimit Urban dhe Investimeve, në cilësinë e anëtarit të KPVV (për periudhën 01.01.2015-30.06.2015), në cilësinë e KVO.

- Për parregullsitë e konstatuara në plotësimin e dosjes së procedurave të prokurimit e blerjeve me vlera të vogla si kërkesat për blerje nuk kanë të argumentuara nevojat, nuk ka argumentim se si është përlllogaritur vlera limit e kontratës (fondit limit), akti i marrjes në dorëzim i shërbimeve dhe i mallrave është bërë nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla dhe jo nga komision i ngritur për këtë qëllim.

- Për pranimin, kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE “Junik “ ShPK, i cili ka ofertuar me 2 preventiva dhe ka fituar me njërin prej preventivave të paraqitur, atë me vlerën më të lartë në shumën 1,535, 608 lekë me TVSH, në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim trotuari fshati Rranxa” në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” nenin 47.

D. VLERËSIM AUDITIMI

Ky auditim në vlerësimin e bërë mbi plotësimin e Programit të Auditimit dhe zbatimit të standardeve, **vlerësohet si auditim i dobët** nga Kryetari, veçanërisht auditimi i procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave për investime, shërbime e blerje mallra, pjesë të caktuara të këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit, do të riauditohen përsëri në një kohë të dytë.

E. DËRGIM RAPORTI PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe ky Vendim, përcillet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, sipas kërkesës së tyre me nr. 9017/1 prot., datë 09.11.2015, të administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr.1035 prot., datë 09.11.2015.

Nga Bashkia Vau Dejës, nuk ka kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në process vlerësimi e zbatimi.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Pal Daçi. Irma Shkupi, Vasil Vane, Berti Meçe dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj

Drejtore i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtore i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT